



Data: 12/08/2021 Ref.: 3039/21

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit për Organizimin dhe Funksonimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës Nr.06/L-113(Gazeta Zyrtare Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr. 05/L-31 (Gazeta Zyrtare Nr.20/12 Qershor 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037(Gazeta Zyrtare Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), si dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 87-të, të mbajtur më 07 dhe 27 Korrik 2021, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohe programet e studimit të Kolegjit Biznesi, për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2021 – 30 shtator 2024:
 - Menaxhimi i Emergjencave, BA, 180 ECTS, maksimumi 120 studentë për vit akademik;
 - Menaxhment dhe Ekonomiks, BA, 180 ECTS, maksimumi 100 studentë për vit akademik;
- II. Riakreditohe programet e studimit për periudhën dy vjeçare, 1 tetor 2021 – 30 shtator 2023:
 - Juridik, LLB, 240 ECTS, maksimumi 50 studentë për vit akademik;
 - Menaxhment dhe Financa, MA 120 ECTS, maksimumi 80 studentë për vit akademik.
- III. Riakreditohe programet e studimit në Degën e Prizrenit për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2021 – 30 shtator 2024:
 - Banka dhe Financa në Biznes, BA, 180 ECTS, maksimumi 200 studentë për vit akademik;
- IV. Numri i përcaktuar i studentëve aplikohet për të gjitha vitet e studimit për periudhën e akreditimit.
- V. Obligohet Kolegji Biznesi që deri më 15 nëntor të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetime

I. Kolegji Biznesi, ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim dhe akreditim të programeve të studimit me stafin akademik si në tabelën e mëposhtme:

<i>Nr.</i>	<i>Programi i studimit</i>	<i>Bartësit e programit</i>
1	Menaxhimi i Emergjencave, BA, 180 ECTS	Adem Musliu Imerlije Alili Milazim Shabani Fatbardha Jashari Violeta Koleci
2	Menaxhment dhe Ekonomiks, BA, 180 ECTS	Shyqeri Kabashi Mustaf Kadriaj Vehbi Imeri Remzi Ahmeti Kujtim Raçi Ylber Krasniqi
3	Juridik, LLB, 240 ECTS	Muhamet Racaj Sejdefa Gjafqë Arben Agushi Mitasin Beqiri Lulzim Farizi
4	Menaxhment dhe Financa, MA 120 ECTS	Ramadan Beqiri Nexhmije Kabashi Ariana Xhemajli
5	Banka dhe Financa në Biznes, BA, 180 ECTS	Brikenda Vokshi Shpetim Reznici Agim Kastrati Sherif Sejdiu

Çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit, duhet të raportohet dhe arsyetohet në AKA brenda 90 ditëve. Lista e përditësuar duhet të aprovohet nga KSHC.

AKA ka organizuar një vizitë me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegjin Biznesi me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit.

Vizitat janë organizuar më 06.05.2021 me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Tornike Khoshtarja, Magdalena Platis, Goce Naumovski, Marija Vasilevska.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të Ekspertëve Ndërkombëtarë kanë hartuar raportet e vlerësimit, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

1. Për programin e studimit Menaxhimi i Emergjencave, BA, 180 ECTS - nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush substancialisht pesë (5) kapituj dhe pjesërisht dy (2) kapituj.

2. Për programin e studimit Menaxhment dhe Ekonomiks, BA, 180 ECTS - nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush substancialisht pesë (5) kapituj dhe pjesërisht dy (2) kapituj.


3. Për programin e studimit Juridik, LLB, 240 ECTS - nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush substancialisht katër (4) kapituj dhe pjesërisht tre (3) kapituj.


4. Për programin e studimit Menaxhment dhe Financa, MA 120 ECTS - nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush substancialisht katër (4) kapituj dhe pjesërisht tri (3) kapituj.

5. Për programin e studimit Banka dhe Financa në Biznes, BA, 180 ECTS - nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush substancialisht katër (4) kapituj dhe pjesërisht tri (3) kapituj.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e 87 të mbajtur më 07 dhe 27 korrik 2021 kanë shqyrtuar aplikacionin e Kolegjit Biznesi dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerrë këtë vendim bazuar në Nenin 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.


Prof. Ass. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare i Këshillit Shtetëror të Cilësisë



Vendimi iu dërgohet:

- Kolegji Biznesi;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.